



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Drenas shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	4.95
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	13/12/2023
Afati për aplikim	14/12/2023 - 12/01/2024
Institucioni	Komuna Drenas
Departamenti	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Divizioni	Spektori i Shërbimit me Qytetarë
Vendi i punës	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Nr. i Referencës	RN00012972
Kodi	RPC0006511



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Në bashkëpunim me kompanitë shërbyese komunale të higjienës dhe furnizimit me ujë, cakton çmimet e shërbimeve komunale; cakton prioritet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues, cakton orarin e reduktimeve dhe prioritetet; dhe mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues dhe ujësjellësit;
2. Bën vlerësimin dhe lëshimin e lejeve për kycje të reja;
3. Bën sigurimin e ujit nëpër pjesët të cilat nuk kanë mundësi të sigurojnë ujë të pijshëm nga rrjeti, përmes rezervuarve;
4. Të hartojnë planin lokal për administrimin e mbeturinave dhe organizojnë administrimin e mbeturinave komunale në territorin e tyre;
5. Të hartojnë raporte vjetore mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorëzojnë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues;
6. Në bashkëpunim me kompanin publike rregullojnë, aprovon dhe e zbatojnë orarin dhe kohën e propozuar për bartjen e mbeturinave dhe mundësinë e futjes në sistemin e bartjes së mbeturinave edhe të fshatrave; dhe Bartjen, deponimin dhe përpunimin e hedhurinave;
7. Organizon aksione të pastërtisë;
8. Kryen edhe punë dhe detyra tjera që i caktohen nga DSHPE në pajtim me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimin të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a të arsimit të lartë Fakulteti Juridik – Drejtimi i Përgjithshëm, më të paktën 240 ECTS;
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore.
- Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Certifikata nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk jeni i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Certifikatë shëndetësore që dëshmon se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore (dorëzohet para emërimit në pozitë);
- Dokument që dëshmon se nuk keni në fuqi ndonjë masë disiplinore për shkelje të rëndë (nese aplikuesi ka punuar ose punon në institucione publike).

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 27/01/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

//

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë



9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

//

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

